




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL IV/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 4 (katërt) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.04.2024
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6343 të datës 28.01.2022;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve;
8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Fshatin Rekreativ-Turistik në Delloc” ;
9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;
10. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Mars 2024;
11. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - e hedhë në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - sot para vetes e kemi projekt-vendimin për shpallje “Qtetar Nderi” të komunës tonë këngëtares ikonike,të guximshme e patrioten Shkurte Fejza.Veprimtaria e saj dhe mesazhet e këngës së saj ishin të padëshirueshme për armikun dhe bartnin rrezik jo vetëm për veten e vet por për familjen dhe shoqërinë.Pavarësisht këtyre ajo vazhdoi këngën e cila nuk ishte vetëm këngë por ishte më shumë se

këngë. Ishte thirrje e mesazh i cili i shërbeu fillimisht për mobilizimin e shqipëtarëve të Kosovës kudo në botë që t'i dalin zot vendit tonë e pastaj kënga e saj shërbeu e u dha zemër djemve e vajzave në t'mirë të kombit të cilët ishin rreshtuar krah për krah njëri tjetrit për çlirimin e vendit. Andaj duke u bazuar në kontributin e Shkurte Fejzës, në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së deklaroj se do ta mbështesim këtë propozim me shpresën që edhe veprimtarët tjerë të nderohen me këtë çmim.

Aziz Bytyqi - natyrisht nuk është e nevojshme të flasim për personalitetin emblematic të këngëtares. Ne si grup e përkrahim këtë ndarje të këtij çmimi.

Dardan Berisha - edhe ne si grup i asambleistëve të PDK-së e përkrahim plotësisht këtë propozim.

Jehona Rrafshi - edhe Nisma Social Demokrate e mbështet këtë propozim. Urime këngëtares tonë të famshme.

Qëndrim Elshani - propozimi për shpalljen "Qytetar Nderi" të këngëtares tonë Shkurte Fejza është shumë i mirëseardhur. Edhe LVV me kënaqësi e voton pro.

Shefket Kolgeci - E tha edhe përfaqësuesi jonë që e mbështesim dhe s'ka dilemë në këtë aspekt. Dua të di iniciativë e kujt ishte? Është e qëlluar dhe me vend dhe e përkrahim. Unë kam pas nderin bashkë me disa veprimtarë të asaj kohe që prej ditës së parë kur ka fillu Shkurtja me këndu ne e kemi përcjell dhe ka qenë një frymëzim i jashtëzakonshëm i asaj kohe.

Kryetari - iniciativën e ka dhënë Fadil Llugaxhiu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6343 të datës 28.01.2022;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën, hap debatin dhe kërkon emrat nga subjektet politike.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit të AAK-së ne propozojmë Saranda Bajraktari.

Alban Berisha - në emër të grupit të LDK-së propozojmë Selman Kolgeci.

Dardan Berisha - PDK nuk ka propozim për këtë komision.

Jehona Rrafshi - nuk kemi propozim nga Nisma Social demokrate.

Qëndrim Elshani - LVV propozon Laureta Tafaj.

Herolind Limaj - Iniciativa Qytetare nuk ka propozim për këtë komision.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e AAK-së Saranda Bajraktari.

21 për, 6 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LDK-së Selman Kolgeci.

13 për, 15 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LVV-së Laureta Tafaj.

12 për, 9 apstenime

Kryesuesi - konstatoj që Saranda Bajraktari dhe Selman Kolgeci kanë marrë shumicën e votave dhe kalojnë. Kërkoj propozimet nga Kryetari.

Kryetari - nga ekzekutivi Armend Krasniqi, Visar Kuçi dhe nga shoqëria civile Erëza Muqa.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4 për formimin e komisionin me këtë përbërje: Saranda Bajraktari, Selman Kolgeci, Armend Krasniqi, Visar Kuçi dhe Erëza Muqa.

27 për, Miratohet pika 4

Flamur Bytyqi - kërkoj sqarim prej zyrtarit ligjor meqenëse ne gjithë kohën kemi dhënë prona në shfrytëzim. Afati i shfrytëzimit për këto prona është 10 vite, a është ashtu?

Kryesuesi - është fjala për lokale dhe seancën e kaluar është caktuar për 15 vite.

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën, hap debatin dhe kërkon propozimet.

Aziz Bytyqi - ne e propozojmë Herolind Limaj.

Bulëza Kuçi - grupi i LDK-së propozon Flamur Bytyqi.

Dardan Berisha - PDK nuk ka propozim për këtë komision.

Qëndrim Elshani - LVV propozon Laureta Tafaj.

Jehona Rrafshi - Nisma Social Demokrate nuk ka propozim.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e AAK-së Herolind Limaj.

19 për, 8 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LDK-së Flamur Bytyqi.

18 për, 5 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LVV-së Laureta Tafaj.

15 për, 6 apstenime

Kryesuesi - konstatohet që Herolind Limaj dhe Flamur Bytyqi kanë marrë shumicën e votave dhe kalojnë.

Kërkoj propozimet e Kryetarit.

Kryetari - nga ekzekutivi Visar Kuçi, Albulena Kokollari dhe nga shoqëria civile Suzana Gashi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5 për formimin e komisionin me këtë përbërje: Herolind Limaj, Flamur Bytyqi, Albulena Kokollari, Visar Kuçi dhe Suzana Gashi.

29 për, 1 apstenim

Miratohet Pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënie e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Kushtrim Kuçi - ne si grup parlamentar e përkrahim këtë iniciativë, jo vetëm të këtij biznesi por secilit biznes që ka për qëllim që tokat vjerrina të shëndrrojnë në fabrika në këtë rast dhe e ka mbështetjen dhe përkrahjen tonë. Shpresojmë dhe i motivojmë qytetarët tjerë që kanë qëllime dhe synime të tilla të vazhdojnë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

28 për, Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve;

Kryesuesi - elaboron pikën, hap debatin dhe kërkon propozimet.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit të AAK-së propozojmë Bexhet Kuçi.

Doruntina Zenelaj - grupi i LDK-së propozon Kushtrim Kuçi.

Dardan Berisha - PDK nuk ka propozim për këtë komision.

Qëndrim Elshani - LVV propozon Laureta Tafaj.

Jehona Rrafshi - NISMA nuk ka propozim.

Herolind Limaj - nuk kemi propozim.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e AAK-së Bexhet Kuçi.

20 për, 4 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LDK-së Kushtrim Kuçi.

14 për, 9 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LVV-së Laureta Tafaj.

10 për, 13 apstenime

Kryesuesi - konstaton që shumicën e votave e kanë marrë Bexhet Kuçi dhe Kushtrim Kuçi. Kërkon propozimet nga Kryetari.

Kryetari - propozon Kymete Bjaraktari.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7 për formimin e komisionit me këtë përbërje: Bexhet Kuçi, Kushtrim Kuçi dhe Kymete Bjaraktari.

25 për, 2 apstenime

Miratohet Pika 7

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Fshatin Rekreativ-Turistik në Delloc” ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Qëndrim Elshani - sa i përket pikës është hera e dytë që po vjen në Kuvend. Cila është arsyeja që po vjen për herë të dytë dhe çfarë arsye ka dhënë ministria që e ka refuzuar herën e parë?

Visar Kuçi - ministria atëherë na ka kthyer një plotësim-ndryshim dhe i ka kërkuar numrat e parcellave dhe sipërfaqet por ne nuk i kemi vazhduar kur i kemi vazhduar dy planet rregulluese të zonave përshkak të buxhetit.

Selman Kolgeci - çështja e këtyre planeve rregulluese të hollësishme ka filluar me kaluar në monotoni. Njëherë e sillni me kaluar, herën tjetër me shfuqizuar, prap e keni sjell për shqyrtim një vendim të tillë. Ju kam pyetur herën e kaluar dhe ju keni thënë që iniciimi i këtyre planeve është konform HZK-së. Është mirë drejtori me na informuar pak për gjendjen aktuale. Si është parapa me PZHK dhe a është parapa me hartu ky plan. Ky dokument përmban edhe numrin e parcellave për dallim prej herës së kaluar të cilat përfshihen në plan rregullues të hollësishëm por ajo që kam vërejtur në këtë dokument është se ndarjet e fundit dhe ri-emërtimet e reja që kanë marrë parcelat pas ndarjes nuk janë përfshi në këtë dokument. Në hartë janë të përfshira por numrat e parcellave nuk janë rifreskuar me numra të ri. Në parim ne jemi pro me bo sa më shumë plane rregulluese e me krijuar sa më shumë mundësi investimi por jo në kurriz të planit të mjedisit.

Visar Kuçi - është fakt që mundet mos me qenë ndonjë parcelë por sipërfaqet janë të gjitha. Sipërfaqja prej 750 ha është pjesë e e zonës kadastrale të komunës tonë. Plani rregullues i hollësishëm në Delloc është i cekur edhe në PZHK dhe HZK kurse pjesa e zonës së mbrojtur malit Sharr nuk është e përfshirë këtu dhe është duke e bërë Ministria e Planifikimit. Është fakt nëse e ke për ndonjë parcelë që s'është numri i asaj parcelle, nuk mund të jetë për shkak se ne i kemi marrë sipërfaqet dhe zonat kadastrale si kanë qenë në HZK dhe nuk na sjell problem. Kur të fillojë Plani rregullues me u hartu merren azhurimi i fundit i këtyre sipërfaqeve dhe numrat e parcellave.

Sanie Kuçi Rexhepaj - jam për me i mbështetur të gjitha planifikimet që bëhen në komunën tonë. Që nga miratimi i PZHK-së komunës tonë iu kanë hapur dyert planifikuese me HZK-në dhe tash edhe me dokumente të tjera që parashihen me anë të dy dokumenteve madhore planifikuese në komunën tonë. Mirëpo unë e kam një shqetësim sepse Komuna po kërkon nga Kuvendi iniciimin për të hartuar këto dokumente planifikuese, komuna po kërkon miratimin e këtyre dokumenteve nga ana e Kuvendit por në anën tjetër komuna nuk po i monitoron dhe nuk po raporton zbatimin e këtyre dokumenteve planifikuese në Kuvend, ndonëse disa herë kam kërkuar raportimin e PZHK-së, që ka dy vite e gjysmë që është miratuar. Kam mbi një vit e gjysmë që është miratuar HZK-ja dhe nuk ka asnjë raportim nga ana e Komunës dhe kjo është

shqetësuese. Në këtë formë vota ime është apstenim, jo për shkak që nuk jam pro hartimit të dokumenteve të reja planifikuese për shkak se janë të planifikuara me HZK mirëpo jam kundër apsolutisht mos raportimit dhe zbatimit të këtyre dokumenteve planifikuese.

Kryesuesi - ne sot po e inicojmë një procedurë për hartimin e planit rregullues të hollësishëm dhe këtë që e tha Sania unë pajtohem plotësisht.

Sanie Kuçi Rexhepaj - pata dëshirë me qenë Kryetari sepse realisht nuk ju kam drejtu drejtorit Visar për shkak se Kryetari ka formuar një komision për monitorimin e këtyre dokumenteve planifikuese dhe desha nga ai të marrë një përgjigje për shkak se në njërin prej mbledhjeve të asamblesë ai ka thënë që janë duke punu por fatkeqësisht nuk kemi asnjë raport të zbatimit të këtyre dokumenteve.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8.

25 për, 1 apstenim

Miratohet Pika 8

Pika 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - ne kemi diskutu për Planin e Veprimit për Transparencën dy muaj më parë dhe i kemi dhënë vlerësimet tona, dhe propozimet tona në ato diskutime dhe normalisht që atëherë e kemi dhënë votën kundër për këtë projekt-vendim për shkak se propozimet tona nuk janë përfill fare dhe tash dy muaj mbrapa detyrohemi prap me diskutu e me vendos për propozimin e njëjtë që kemi diskutu e keni vendos ju dy muaj më parë. Mënyra se si po përgaditen dokumentet që na vin përpara është jo serioze dhe si rezultat i saj ne në vazhdimësi detyrohemi me votu e na kthehet për me votu prap të njëjtin dokument.

Transparenca nuk është një dokument i cili po i mungon Komunës dhe nuk e ka dhe hajde ta bëjmë një se nuk e ka. Transparenca është vullneti i një pushteti i cili don apo nuk don me qenë transparent para asambleistëve e para qytetarëve e para secilit vendim që vet e merr. Ky pushtet në vazhdimësi ka dëshmu që fare lidhje me transparencë nuk ka. Për ta vëretu unë dua të përmend disa shembuj që e dëshmojnë një gjë të tillë. Dy vite radhazi ne si grup i LDK-së kemi kërku që të formohet një komision i cili do të mbikqyr listën e investimeve kapitale që janë realizu. Në të dy rastet ju nuk e keni leju me u formu një komision i tillë sepse nuk keni dasht me pas transparencë për ato investime që janë bë. Në pyetjet që ne i ngrisim si asambleist në shumë raste ne nuk marrim përgjigje fare. Tri pyetjet e fundit që i kam ngrit në Asamble, unë edhe sot ende nuk kam marrë përgjigje. Si mund të jeni transparent kur ju nuk i përgjigjeni përfaqësuesit të qytetarëve? Në shumë shkresa që ne si LDK i kemi adresu për çasje në dokumente zyrtare, ne në disa raste nuk kemi marrë përgjigje dhe në disa raste kur kemi marrë përgjigje kemi pas devijime të përgjigjeve. Ajo nuk është transparencë. Raportimi për zbatimin e planeve rregulluese, pse duhet një asambleiste me kërku raportin gati çdo mbledhje kur ju e keni obligim ligjor me sjell? A ka një shkrim që çoftë në platformën e komunës apo në llogarinë facebook të Komunës një qëndrim i opozitës që është vendos aty? Asnjëherë! Unë do të doja që edhe këtë plan dhe çdo plan që është i mirë, ta miratoj por kur e shohim edhe si grup një qasje të tillë ndaj transparencës, ne nuk duam të bëhemi pjesë e një diçkaje që është farcë para njerëzve dhe sigurisht vota jonë do të jetë kundër këtij projekt-vendimi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 9.

16 për, 7 kundër, 1 apstenim

Miratohet pika 9

Pika 10. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Mars 2024;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - kur jemi te informata për tremujorin e shpenzimit të buxhetit, e kuptoj që ka shumë vështirësi ekzekutivi që me bë shpenzime të buxhetit në mënyrën më të mirë për shkak se është tremujori

që nënkupton sezonën e dimrit dhe punët kanë vështirësi mirëpo duke marrë shkas nga viti i kaluar ku mënyra se si është shpenzu buxheti vitin e kaluar ka qenë shumë shqetësuese,unë dua t'ua tërheq vërejtjen tash që të mos na përsëritet viti i kaluar duke marrë për bazë që vitin e kaluar për shkak të një keq menaxhimi të parasë publike kanë mbet pa shpenzu mbi 2 milion euro.Ndërkohë kur flasim për këtë tremujor për investimet kapitale në krahasim me vitin e kaluar është diçka më mirë por në vlerësimin tim është prap pak sepse kemi dikun 7 % të investimeve kapitale të shpenzuar.Këtë shqetësim që po e ngriti dua që ekzekutivi ti merr sa më seriozisht këto vërejtje,me fillu sa më herët ekzekutimin e buxhetit që mos me u koncentru 80 % e buxhetit sikurse ka ndodh vitin e kaluar vetëm tremujorin e fundit e pastaj me pas vështirësi në shpenzimin e parasë dhe me pas edhe suficit dhe mbetje e pastaj duhet të bartet për vitin tjetër.Mënyra si ju po e ekzekutoni këtë buxhet edhe mbi bazën e asaj që kemi thënë dhe për projektet konkrete është e çuditshme dhe për keqardhje.P.sh. Rruga “Dukagjini “ në Bllacë është bërë para 5 muajsh,ajo rrugë është për keqardhje.Ajo që më shqetëson është që ndonjëherë mund të bëhet puna e keqe por cila masë u marrë ndaj dikujt?Nëse dikush nuk e ka kry punën mirë,ma thoni një masë që e keni marrë ndaj një zyrtari që e ka pas përgjegjësi me menaxhu atë pjesë dhe nuk e ka menaxhu si duhet? 3-4 herë intervenime në Bllacë te ndriçimi dhe sot prap ka probleme me ndriçim.Gati në secilin projekt ka vështirësi dhe probleme me cilësinë e punimeve.

Pika 11. Pyetje dhe përgjigje;

Shefket Kolgeci - para dy-tre mbledhjeve unë kam kërku nga ekzekutivi konkretisht nga Drejtori i Shërbimeve Publike që të formohet një komision në nivel ekspertësh në nivel të komunës që të shkoj të vifikoj kanalizimin që është vendos para gati dy vite e që është inekzistent,nuk funksionon.A ka bërë në atë drejtim diçka drejtori?Nëse nuk ka diçka unë prap kërkoj që të bëhet diçka në atë drejtim dhe të funksionalizohet ai kanalizim.Pyetje për Drejtorin e Arsimit: shkolla në Vraniq është për keqardhje.Janë bërë shumë punë të mëdhaja por në plan ka qenë që për tre vite të përfundoj ajo shkollë dhe tani është viti i katër.Nëse kryhet shtatorin e ardhshëm do të ishte mirë.Me sa kam informata aty janë ndërpre të gjitha punimet dhe kërkoj sqarime.A do të fillohet ajo shkollë dhe a do të kryhet ajo shkollë?

Kryetari - ke plotësisht të drejtë.Ka qenë propozimi juaj atëherë për kanalizimin në Vraniq dhe nëse nuk gaboj i kemi nda 130.000€.Kompania ka hy me 80.000 ose 90.000 dhe në aspektin ligjor na ka mund të gjithëve mirëpo e kemi pas një problem ku nuk kemi mundur të dëpërtojmë në anën e majtë dhe të djathtë me kalu nëpër prona.Jemi mundu me bërë punë e s'kemi mujt me bërë punë dhe me të vërtetë për me kry punën e Vraniqit duhet me shku në anën e majtë dhe në anën e djathtë me kry kanalizimin..Sa i përket shkollës në Vraniq edhe për ne nuk është mirë sepse janë bërë 6 vite.Ka pas problem me operatorë,ka pas problem me pagesa për shkak të pandemisë 2020-2021 dhe momentalisht sa e di është ndërpre një kontratë.Të njëjtin problem e kemi edhe te qerdhja e fëmijëve ku prej dy vitesh presim me u mbush me inventar.Kryetari tutje jep sqarime edhe sa i përket projekteve tjera.

Flamur Bytyçi - Qendra “Dua” pse nuk po funksionalizohet tash e sa kohë? Kryetari foli për qerdhen por nuk e kuptova.Pse u dasht me prit kaq shumë kur ajo qerdhe që është e ndërtuar ka fillu me u dëmtu vetvetiu?Ka afër 6 muaj që në faqen e komunës nuk figuron që janë lëshu leje ndërtimore. Pse nuk po i lëshoni lejet ndërtimore?Nëse ju vazhdoni kështu,kjo i shkakton humbje komunës.

Kryetari - qerdhja ende nuk është pais me inventar dhe sa ma shpejt që bëhet neve na konvenon më shumë sepse kemi numër të madh të nxënësve mirëpo procedurat ne nuk i menaxhojmë por bëjmë presion vazhdimisht. Sa i përket lejeve ndërtimore,janë të parapara me kushte dhe zbatohet ligji që është në fuqi aq sa është e paraparë.Sa i përket qendrës “Dua”,ajo duhet me qenë e licencuar dhe ne duhet me fut në buxhet për vitin e ardhshëm me i ndihmu me shërbime ashtu si i ndihmojmë Hendikosit.Përndryshe është me donator edhe më tutje,objekti është pronë komunale mirëpo pa e marrë shoqata licencën ne nuk mund ti ndihmojmë si komunë.

Flamur Bytyçi - stafi të cilët kanë punu,a ka me qenë staf i komunës apo do ta menaxhojë dikush tjetër qendrën “Dua” ?

Kryetari - nuk kemi mundësi.Ne nuk mundemi me pagu paga sepse nuk mund ti fusim në sistem të pagave sepse nuk na mundëson ligji por mund ti ndihmojmë vetëm përmes shërbimeve.

Sanie Kuçi Rexhepaj - pyetje për Kryetarin: në njërën prej asamblesë na keni thënë që e keni formu komisionin për monitorimin e PZHK-së dhe HZK-së. A mund të na njoftoni se ku janë me proces ky komision dhe kur pritet me na ardhë ai raport i PZHK-së dhe i HZK-së për shkak se na është premtu në dhjetor, në janar, në shkurt por tash jemi në muajin prill dhe nuk e kemi ende raportin.

Kryetari - është e vërtetë që është formu komisioni. Ju ka kërku të gjitha drejtorive me i sjell shënimet e sakta për vitin e kaluar se çka është punu, çka ka ndryshu te planet zhvillimore dhe të hartave zonale. Besoj që në momentin që vin të gjitha shënimet për vitin e kaluar, bëhet një raport dhe sillet në Asambleenë komunale. Raportin shumë shpejt do ta keni.

Urim Suka - muajin e kaluar kam bërë tri pyetje dhe nuk kam marrë përgjigje dhe për mua është shqetësuese sepse unë nuk e di se cili ka me qenë fati i rrugës Ali Shabani, Fan Noli në Suharekë dhe cili ka me qenë fati i shtegut të biçikletave dhe gjithëashtu gropat mbrapa muzeut te shkolla “7 Marsi”? Tani kam 3 pyetje për këtë asamble dhe uroj që të mos e kenë fatin e pyetjeve paraprake. Këto ditë deri sa po zhvillohen punimet në sheshin e qytetit kam marrë shumë shqetësime qytetare për mungesën e theksuar të sigurisë në vendpunishte. Për mua është e papranueshme që të lejohet që të ekzekutohen punimet në këtë formë ku qytetarët si me makina dhe veqanërisht këmbësorët lëvizin pa patur një orientim të qartë se ku është hapsira për ta. A jeni në dijeni për gjendjen në këtë vendpunishte? Sa janë duke u zbatuar masat e sigurisë në punë në bazë të legjislacionit në fuqi? Cilat janë masat që ju keni ndërmarr për rritjen e sigurisë në punë për këtë vendpunishte? Kur jemi te sheshi, e kam pranë një informatë lidhur me punimet në këtë shesh dhe është fjala për demolimin e objekteve që ishin në këtë shesh. Ky demolim nuk është paguar nga pozicioni i paraparë me kontratë por për demolimin e këtyre objekteve është bërë një pagesë nga një buxhet tjetër nga drejtoria e inspeksionit. Dua të di nga ju të vërtetën e kësaj çështje sepse nëse është kështu siq jam i informuar, këtu kemi dëmtim të qëllimshëm të buxhetit të komunës. Pyetje për Drejtorinë e Kulturës: në thirrjen e dytë të subvencioneve nga drejtoria e kulturës ju keni marrë një aplikacion për mbështetje për botimin e librit “Masakra serbe në komunën e Suharekës 1998-1999” nga autori Rrahman Rexhaj. Ky libër ka rreth 520 faqe ku argumenton në detaje të gjitha vrasjet, masakrat serbe në komunën tonë. Ky libër që nga muaji tetor ishte i gatshëm për botim mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve financiare ka mbetur ende pa botuar. Ajo që për mua është e çuditshme dhe e papranueshme është fakti që ju keni refuzuar aplikacionin e tij duke mos ndarë mjete për botimin e këtij libri. Cila është arsyeja e këtij refuzimi dhe a keni ndonjë mundësi tjetër për mbështetjen financiare të këtij libri? Pyetje për Drejtorinë e Financave: këto ditë kam pranuar një shqetësim nga një biznes që operon në zonën industriale e që këtë shqetësim e kanë ngritur të paktën 22 biznese që operojnë në këtë zonë. Me date 26.01.2024 Drejtoria e financave i ka ngarkuar bizneset që operojnë në zonën industriale me tatim në pronë për ngastrat e dhëna me qera dhe ato reaktive nga viti 2021. Paradoksi i gjithë kësaj situatë është se prona për të cilat janë ngarkuar bizneset janë prona të komunës së Suharekës ndërsa bizneset në fjalë për këto prona paguanjën rent vjetore. Edhe më i çuditshëm është fakti që kjo drejtori me date 04.04.2024 i ka ngarkuar bizneset në fjalë me kamata për vonesën me pagesën e rentës për tërë vitin kalendarik 2024. Pse janë ngarkuar me kamatë për tërë vitin edhe pse jemi në fillimin e tij?

Kryetari - nëse nuk jam gabim bëhet fjalë për tatimin në pronë. Tatimin në pronë nuk e cakton asambleja komunale por është vendim i qeverisë së RKS-së që është i përcaktuar në çdo komunë.

Agim Bylykbashi - unë e di që janë ngarku të gjitha bizneset në zonë në tatimin në pronë. Nuk është çështje e komunës por ministria e financave i merr shënimet nga agjensioni kadastral i Kosovës dhe ngarkohen të gjitha tokat pa marrë parasysh ku janë. Edhe bizneset janë ngarkuar në këtë rast në zonën industriale. Edhe mua më është dukur e palogjikshme dhe ne kërkesën e tyre e kemi dërgu në Ministrinë e Financave dhe jemi duke prit përgjigje. Sa i përket kamatave është e vërtetë që kanë kamata dhe në kontratë secilit prej tyre i shkruan që ngarkohen me kamatë nëse nuk i kryen obligimet me kohë mirëpo këtu është një problem sepse disa kontrata janë në fillim të vitit, disa kontrata janë në fund të vitit dhe ne i kemi ngarku në fillim të vitit dhe tash kemi marrë vendim me ia heq ato kamata që i kanë pas dhe kemi vendos që në fund të vitit me i ngarku të gjithë me kamata ashtu si i shkruan në kontratë.

Lorika Gashi - Rrahmani ka marrë në thirrjen e parë të vitit 2023 me të njejtin titull, me të njejtin projekt. Projektet e njehta nuk përkrahen dy herë nga i njehti institucion sepse nuk e lejon rregullorja.

Urim Suka - çështja për shkak të ndjeshmërisë së botimit që ai e ka unë e mora si shqetësim serioz dhe desha ta adresoj për faktin që në thirrjen e dytë unë e pash që është një libër që është mbështet me 7000€ e që shkruhet për një person. Janë ndarë paratë dhe libri ende nuk është botu sipas informatave që kam. Unë nuk e kontestoj mirëpo për një libër që i pasqyron të gjitha vrasjet dhe ato që kanë ndodh për komunën tonë janë nda 1000€ në thirrjen e dytë për përgaditjen e materialit. Këtu çështja e thirrjes së dytë ka qenë me u mbështet dhe me u financu. Unë mendoj që kjo është dasht të merret me prioritet. A ka mundësi ju me gjet një fond që e mbështetni këtë libër sepse mendoj që është interes publik.

Kryetari - ai ka qenë para një muaji në zyrë dhe ju kam thënë konkuroni si të gjithë kur të shpallen subvencionet. Më vjen keq që kemi edhe 5 kërkesa për subvencione që kanë me konkuru për botimin e librave të reja. Krejt shkruajnë për dëshmorët. Dëshmorët janë të njejtë dhe afërsisht janë 120 por ne nganjëherë edhe po bëjmë sherr sepse ende s'ka përfundu puna që e kemi me shtetin e Serbisë ku kemi ende shumë probleme.

Lorika Gashi - e kuptoj ndjeshmërinë e autorit dhe temës të cilën e ka zgjedh por problemi i dallimit që e potencove 7000€ dhe 1000€ është sepse autori për Mulla Nurën ka aplikuar si OJQ dhe mundësia e subvencionit për individ te ne maksimumi është 1000€. Drejtoresha tutje jep sqarime.

Urim Suka - Një punë kaq e madhe që e ka bërë një autor bashkë me një autor tjetër dhe që kanë mbledh fakte gjithëandej nuk është e ndershme me iu përgjigj në këtë formë. Nëse s'ke mjete mundesh mos me mbështet por me thënë kopi paste ajo nuk është e drejtë.

Kryetari - unë thash tjetër gjë. Sa i përket pagesës së sheshit në projekt janë parapa 1300€ për rrënimin. Aty do të hiqet trafa, do të hiqet lapidari dhe do të kaloj më lart. Lokalet që janë prish poshtë nuk kanë qenë në rrënim aty brenda por sheshi e përfshin komplet. Kërkone, është pagesa shtesë dhe është bërë me kompaninë e rrëtimeve. Sa i përket sheshit nuk është e lehtë sepse është komplet infrastrukturë. Është duke shku sipas planit dinamik dhe unë besoj që deri në fund të qershorit kryhet. E cekë shtegun e ecjes, është e paraparë me kontratë dy vjeqare dhe besoj shpejt përfundon. E përmende rrugën Sali Shabani, ne kemi problemet më të mëdhaja me hidro regjionin dhe besoni aty ku punojnë e lënë mjerin dhe të njejtin problem e kemi edhe te rruga Xhavit Sylja. Te rruga mes stadionit dhe muzeut unë i kam pa ato gropa dhe ajo mund të rregullohet me sanime kur të fillojmë me sanimet.

Urim Suka - te rrënimi unë kam informatë, nuk e kam të vërtetuar por e kam shiku pastaj kontratën dhe pozicioni në kontratë figuron që ato demolime e ke në pozicionin në kontratë e sipas informatës është bërë rrënimi me tjetër pozicion dhe nuk është shfrytëzuar ai pozicion që është në kontratë. Te pjesa e punimeve në shesh unë nuk fola se kur do të kryhen punimet por fola për sigurinë.

Liridon Fandaj - Kryetar është premtim elektoral i yti dy mandatet uji në Peqan. I janë dhënë afër 80.000€ Hidroregjionit për me zgjidh këtë problem por nuk është zgjidh. Gjatë viti 2023 dhe 2024 në fshat janë hap rreth 30 puse dhe minimum 2000€ është një pus. Asnjëherë nuk e kemi një raport se çka ka bërë Hidroregjioni në fshat përveq që po vendosin puseta por nuk kemi zgjidhje të asaj që kërkojnë qytetarët. E pash një punim që po bëhet në parkun e qytetit, një trafostacion. A kanë leje ata për atë trafostacion që janë duke e bërë dhe a e kanë marrë në shfrytëzim këtë pjesë pasi është publike?

Kryetari - ka qenë një delegacion i KEK-ut para një jave. Unë i falemderoj pasi që atë punë ne s'mundemi me kry. Ajo zhvendoset në ato metra katrorë dhe vetëm bëhet bartja e trafës sepse lokacioni i njejtë është. Është e vërtetë që kam premtuar në mandatin e parë për ujë, jam mundur dhe e kam dhënë maksimumin. Kemi problem pasi nuk duan që të vendosin orëmatësit jashtë rrugës. Unë sa herë ka nevojë do të mbështes me mjete financiare. Raportin mund ta kërkon zyrtarisht.

Liridon Fandaj - Kryetar është e vërtetë. Unë kam qenë edhe në takim kur ke qenë te shkolla por kërkesa e qytetarëve ka qenë që ai rrjet me u zhvendos sepse është rrjet i vjetër dhe vet Hidro Regjioni nuk e din ka janë gypat. Nëse është një kosto aq, pse mos me vendos një rrjet të ri.

Kryetari - vitin e kaluar janë nda për fshatin Bllacë 200.000€. Hidroregjioni ka pas me hy me 210.000€. Është një memorandum mirëpo ata kanë shku e kanë shpall vetëm fazën e parë me 180.000 dhe kanë mbet edhe 20.000€ të viti të kaluar. Për fat të mirë sivjet e kanë shpall me mjete të veta. Duhet të na kuptoni që Hidroregjioni është kompani shtetërore dhe i jep llogari Ministrisë së zhvillimit ekonomik dhe jo neve. Kryetari tutje jep sqarime.

Alban Berisha - së pari dua ti shpreh ngushëllime familjes që dje ka ndodh një aksident në territorin tonë.

Si Komunë a bëhet ndonjëherë ndonjë analizë ku janë këto zona të rrezikshme? Nuk po them për këto me vdekje prurëse sepse zakonisht ato janë rrugë magjistrale të cilat janë në menaxhimin e Ministrisë së infrastrukturës por e jona është me bo parandalim të këtyre rasteve e sidomos në qytet. E dim që kemi punime në rrugë dhe mund të ndodhin aksidente të vogla që nuk janë ndoshta të dëmshme fizikisht por dëme materiale për pronarët e veturave ka mjaft dhe e dime që secili qytetar i paguan 40€ euro taksë rrugore, që ato shkojnë në konton e Ministrisë së Infrastrukturës dhe 10 taksë komunale dhe kjo është shumë papërgjegjësi. Kryetar pse hapen shumë fronte përnjëherë si rruga e Reshtanit, Brigada 123 dhe nuk din njeriu ka me shku. Dua ta di pse hapet një kanalizim pastaj mbyllet dhe hapet prapë? Thonë që Komuna e ka kry të veten dhe tash ka ardhë Hidroregjioni. Kryetar ti je i zoti i tokës, komunës tonë dhe nuk është kush don, kur don me ardhë me qel kanale dhe në fund po e pësojmë ne. Ti je votu prej qytetarëve me mbrojtë interesin tonë. Te rrugët e qytetit, është një fluks i madh te Viva dhe janë shumë lokale te ndërtesa e re përball Vivës, a ka dikush që e ka bërë një analizë të saktë? Si me bërë të lehtë jetën e qytetarit që aty me u kyq prej krahut të djathtë me shku në krah të majtë? Unë e di që dy -tre vjet Qëndrimi e ka cek këtë.

Armend Krasniqi - duke marrë parasysh të gjitha problemet që ti i ceket më parë, i ka shqyrtu mirë Komuna e Suharekës dhe sëbashku me UNDP kanë përgaditur një plan të mobilitet. Çdo parregullsi, çdo vështirësi që e kemi pas në komunë, tash e kemi një plan ku në kuadër të atij plani kemi alternativa. Komuna e Suharekës është ndër të paktat komuna në Kosovë që e ka një plan të detaizuar se si duhet të veprohet në të ardhmen dhe shumë shpejt çdo alternativë e atij projekti do të fillojë të zbatohet.

Alban Berisha - e di që dokumenti është dhe e kemi votu edhe ne. Shpesh është diskutu për pikën pyetje dhe përgjigje dhe jam në mesin e atyre që kam thënë me gjet një zgjidhje për këtë pikë por sinqerisht mua më duket që është shumë falls si pikë. Iu kam drejtu Drejtorit të Arsimit për nxënësata në Shirokë dhe nënkryetarja e ka dhënë një përgjigje. Çfarë masa keni me ndërmarrë që ata nxënësata të shkollës së mesme teknike po dalin në rrugë? E di që Drejtori i Arsimit ka drejtë me thënë që s'mund ti përcjell jashtë shkollës çka bëjnë por ata kur janë grup është përgjegjësi e të gjithë neve. Zakonisht te ne po duhet me ndodh një aksident e pastaj ne m'u mbledh dhe me marrë masa. Sinqerisht duhet me ia nis me punu pak më përgjegjshëm.

Kryetari - ju që jetoni në Suharekë e dini që gypat e ujit kur janë vendos në Suharekë. Një projekt që ka qenë te rruga e Reshtanit dhe tash Hidroregjioni kanë kërku shtesë 160-tësh në anën e djathtë duke shku posht dhe 110-tësh pjesën tjetër dhe nuk është e lehtë ndërrim pozicionit sepse nuk mund të bësh çka të duash. Punët e mëdhaja nuk bëhen shpejt dhe sa i përket sigurisë ke të drejtë por kompania që ndërton duhet me i vendos shenjat e sigurisë. Te viva ke plotësisht të drejtë por do të shohim me planin e mobilitetit çka bëjmë dhe si e bëjmë.

Qëndrim Elshani - së pari dua të jap një vërejtje sepse nuk ka transmetim live që një kohë por besoj që është problem teknik dhe rregullohet. Kam një shqetësim prej banorëve të lagjes "Xhavit Sylaj". Aty javët e fundit ka pas punime në rrugë dhe përpos që nuk është rregullu rruga sikur në gjendjen e mëparshme si ka qenë, gypat që janë shtrur aty sipas banorëve të lagjes janë shumë herë më të vegjel se sa si janë parashiku në kontratë. Gypat që janë shtrur aty janë 17 cm ndërsa në kontratë duhet me qenë 35 cm. Kjo informatë më ka ardhë dje dhe nuk kam mujt me vërtetu mirëpo po e them sot sepse pas një muaji mund të jetë vonë.

Kryetari - unë ka qenë në vend të ngjarjes dhe nuk besoj që ka gypa 17 të kanalizimit. Do të interesohemi sepse çka s'mund të ndodh por nuk besoj që ka ndodh.

Qëndrim Elshani - unë po flas sipas banorëve të lagjes të cilët ma kanë dërgu një foto ku shihet se gypi është 17 cm. Nëse qëndron kjo e banorëve të lagjes po pres që deri seancën e radhës të merren masa dhe të rregullohet rruga.